




Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Home Affairs FDHA
Federal Social Insurance Office FSIO

Përkuçdesja profesionale (Shtylla e 2-të)

Përfitimi nga kursimet me
disponim të lirë:
Mos harroni depozitën tuaj
të përkujdesjes!



Në këtë broshurë unë gjej të gjitha informacionet e rëndësishme për temën e përfitimit nga kursimet me disponim të lirë.

Kujt i drejtohet kjo broshurë?

Unë duhet të kujdesem për përfitimet e mia nga kursimet me disponim të lirë, nëse njëra prej situatave të mëposhtme qëndron përmes:

- 1** Unë e ndërroj punëdhënësin.
- 2** Pas një ndërprerjeje unë filloj në një vend të ri të punës.
- 3** Unë dëshiroj që ta plotësoj depozitën time të përkujdesjes.
- 4** Unë e reduktoj ose e mbaroj veprimtarinë time të punës, por nuk jam i pensionuar akoma.
- 5** Unë jam i papunë.
- 6** Unë dëshiroj që ta marr përfitimini tim nga kursimet me disponim të lirë para moshës së pensionit.
- 7** Unë shkurorëzohem.
- 8** Unë marrë një pension të ri invalidi.
- 9** Unë e arrij moshën e pensionit.
- 10** Çfarë ndodh në rast të vdekjes sime?

Termat më të rëndësishme
sqarohen në fjalorthin në
fund të kësaj broshure.

Përgjigjet për pyetjet tuaja

Si mund të di, nëse jam ose kam qenë i/e siguruar në shtyllën e 2-të?

Ju mund t'i kontrolloni illogaritjet e pagës, nëse paguhën kontributë përkujdesjen profesionale. Përveç kësaj Arka juaj Pensionale (institucioni

i përkujdesjes) duhet t'ju dërgojë çdo vit një déftesë

sigurimi, e cila ju informon mbi depozitën e kursyer në

përkujdesjen profesionale dhe pagesat, të cilat kanë

të njarë se ju përkasin më vonë. Nëse ju dëshironi

të merrni njoftime përfitimet nga kursimet me

disponim të lirë dhe nuk keni më asnjë mundësi që ta

kontaktoni punëdhënësit tuaj të mëparshëm dhe Arkat profesionale të

tyre ju mund t'i drejtoheni edhe zyrës qendrore të shtyllës së 2-të, e cila

do t'i bëjë për ju sqarimet e nevojshme (adresa në fund të broshurës).

Për të shmangur që ju të duhet të kérkonit për të gjetur depozita nga

kursimet me disponim të lirë ruajini déftesat tuaja të sigurimit.

Ruajini déftesat tuaja të sigurimit.

A kam unë një depozitë nga kursimet me disponim të lirë dhe ku ndodhet ajo?

Nëse ju supozoni që të keni një depozitë nga kursimet me disponim të lirë por nuk dini se ku ndodhet ajo, drejtohuni zyrës qendrore të shtyllës së 2-të, e cila i bën për ju sqarimet e nevojshme (adresa në fund të kësaj brochure).

Për të shmangur që institucioni juaj i kursimeve me disponim të lirë të humbë kontaktin me ju, mos harroni që t'ia njoftoni çdo ndryshim të adresës, sidomos kur shpërngulen jashtë vendit.

Shitjet:

BBL, Verkauf Bundespublikationen, CH-3003 Bern

www.bundespublikationen.admin.ch

Art.-Nr. 318.790.ALB

01.24 150 860544917

Kjo broshurë ndërmjetëson një vështrim të përgjithshëm. Për vlerësimin e rasteve të veçanta janë vendimtare dispozitat ligjore, rregullat sipas rregullatoreve dhe kontratave.

Cilat hapa duhet tē ndërmarr unë:

1 Nëse unë e ndërroj punëdhënësin?

Nëse ju jeni siguruar në shtyllën e 2-të dhe e ndërroni punëdhënësin, ju mbeteni parmisht i siguruar detyrimisht dhe përfitimi juaj nga kursimet me disponim të lirë i duhet t'i paguhet Arkës Pensionale të punëdhënësit tuaj të ri. Ky transferim kerkohet me ligj. Arka juaj e mëparshme Pensionale duhet t'ju pyesë për të dhënët e kontaktit të Arkës suaj të re Pensionale. Përndryshe ju duhet tē interesoheni tek punëdhënësi juaj i ri për adresën e Arkës së tij Pensionale dhe t'ia njoftoni atë Arkës suaj të mëparshme Pensionale, në mënyrë që kjo mund ta transferoje përfitimin nga kursimet me disponim të lirë.

Nëse Arka juaj e mëparshme Pensionale nuk merr të dhëna për Arkën Pensionale të punëdhënësit tuaj të ri, atëherë ajo nuk mund ta transferojë përfitimin nga kursimet me disponim të lirë

Kontrollojeni llogarinë e Arkës suaj të ri Pensionale.

dhe duhet t'ia transferojë këto Fondacionit të institucionit të mbledhjes BVG.

Kontrolloni, nëse shuma e përfitimin nga kursimet me disponim të lirë në llogarinë e Arkës suaj të mëparshme përputhet me atë shumë, e cila shënohet në dëftesën e sigurimit të Arkës suaj të ri Pensionale.

Mund tē ndodhë që Arka juaj e re Pensionale nuk mund ta marrë përsipër gjithë shumën e transferuar, sepse niveli i pagesës është më i ulët sesa tek arka e vjetër. Në atë rast pjesa e mbipaguar e përfitimit nga kursimet me disponim të lirë duhet t'i transferohet një të ashtuquajtur institucioni të kursimeve me disponim të lirë.

2 Nëse unë filloj në një vend të ri të punës pas një ndërprerjeje?

Nëse midis dy marrëdhënieve të punës ka një ndërprerje, atëherë përfitimin nga kursimet me disponim të lirë ndodhet gjatë kësaj kohe në një institucion për kursimet me disponim të lirë. Prandaj ato duhet tē kalohen në Arkën Pensionale të punëdhënësit tuaj të ri. Arka juaj e re Pensionale do t'ju dërgojë një pyetësor, të cilin duhet tē mbushni plotësisht.

3 Nëse unë dëshiroj që ta plotësoj depozitën time të përkujdesjes?

Mund tē ndodhë që përfitimi i transferuar nga kursimet me disponim të lirë është tepër i ulët për të fituar një të drejtë për të gjitha pagesat e rregullta të Arkës së re Pensionale. Atëherë Arka juaj e re Pensionale duhet t'ju mundësoj që ta plotësoni depozitën tuaj të moshës nëpërmjet një transferimi të njëhershëm të parave ose që ta plotësoni nëpërmjet transferime të disahershme të parave. Kjo quhet blerje. Blerja i shërben mbushjes së boshillëqeve në përkujdesjen profesionale.

Blerja asnjëherë nuk është e detyrueshme dhe mund tē hiqet, si rregull, nga të ardhurat e tatueshme.

4

Nëse unë e mbaroj veprimtarinë time të punës ose e reduktoj shkallën e punësimit tim, por nuk jam i/e pensionuar aksoma?

Nëse ju e mbaroni veprimtarinë tuaj të punës ose të ardhurat tuaja të reja janë më të ulëta sesa shuma e nevojshme për sigurimin në shtyllën e 2-të, ju duhet të lini që pagesa tuaj e lirimit të transferohet në një institucion të kursimeve me disponim të lirë.

Varet nga ju që të bëni që përfitimi juaj nga kursimet me disponim të lirë të transferohet në llogarinë e një institucionit të kursimeve me disponim

Varet nga ju që ta bëni transferimin.


të lirë dhe Arka juaj e mëparshme Pensionale të vihet në dijeni mbi vendimin tuaj. Nëse ju nuk e informoni Arkén tuaj Pensionale, atëherë kjo brenda një afati prej gjashtë muajsh, por jo më vonë sesa pas dy vitesh, do t'ia transferojë këtë përfitum nga kursimet me disponim të lirë Fondacionit të institucionit të mbledhjes BVG

(adresa në fund të këtij fletëudhëzimi), e cila është kompetente për këtë

në mënyrë speciale.

Ju e keni vetë në dorë që ta ndërroni institucionin për kursimet me disponim të lirë, për shembull, nëse ju konstatoni që një institucion tjetër ofron interesa më të mira.

Nëse ju dëshironi që ta vazhdoni përkujdesjen profesionale në mënyrë vullnetare, ju mund të siguroheni ose tek Fondacioni institucion i mbledhjes BVG ose tek Arka juaj e mëparshme Pensionale nëse kjo e lejon në rregullat e tyre dhe ju jeni siguruar në AHV zviceran. Por ky vendim duhet të merret menjëherë pas daljes nga Arka Pensionale.



5 Nëse unë jam i/e papunë?

Gjatë papunësisë suaj përfitimi juaj nga kursimet me disponim të lirë duhet të depozitohet tek një institucion i kursimeve me disponim të lirë. Për që kohë se ju merrni asistencë papunësie dhe një pagesë ditore prej më shumë se 87.10 franga (gjendja 2025) jujeni siguruar detyrimisht tek Fondacioni i institucionit të mbledhjes BVG për riskun e invaliditetit dhe atë të vdekjes, por nuk kurseni më për pensionin tuaj të pleqërisë. Nga përkujdesja profesionale për persona të papunë nuk ka asnjë pension pleqërie, por vetëm pensione invaliditeti dhe pensione të trashëgimtarëve; pensione të mundshme të invaliditetit nga kjo përkujdesje mbarojnë gjatë arritjes së moshës së pensionit. Gjysma e kontributave hiqet nga asistenca juaj e papunësisë, gjysma tjetër paguhet nga sigurimi i papunësisë. Nëse ju gjatë arritjes së moshës së pleqërisë keni akoma një përfitim nga kursimet me disponim të lirë, atëherë drejtobuni, ju lutemi, institucionit tuaj të kursimeve me disponim të lirë. Nëse ju dëshironi të përkujdeseni edhe për një pension pleqërie, ju mund të bënë një kërkeshë për vazhdimin vullnetar të përkujdesjes suaj profesional ose tek institucioni i mbledhjes BVG ose tek Arka juaj e mëparshme Pensionale, nëse kjo e lejon këtë në rregulloren e saj. Kusht përvazhdimin vullnetar është që jujeni i/e siguruar në AHV zviceran. Por ky vendim duhet të merret menjëherë pas daljes nga Arka Pensionale. Nëse punëdhënësi ju ka pushuar nga puna dhe ju në fund të marrëdhënies së punës jeni të paktën 58 vjeç/e, ju keni edhe një mundësi tjetër përvazhduar përkujdesjen tuaj profesionale vullnetarisht. Nëse ju nuk gjeni një vend të ri pune dhe prandaj nuk hyni në një Arkë të re Pensionale, ju mund të mbeteni të siguruar në Arkën tuaj të deritanishme Pensionale deri në moshën e pensionit. Ju mund të zgjidhni, nëse ju dëshironi apo jo të paguani edhe kontribute kursimi dhe në moshën e pensionit keni të drejtë për një pension pleqërie. Ju duhet të jeni siguruar gjithashtu edhe më tej në AHV-në zvicerane. Arka juaj e deritanishme Pensionale ju informon më saktësisht mbi këtë vazhdim vullnetar të përkujdesjes profesionale. Kjo mundësi ekziston vetëm për persona, marrëdhëniet e punës së të cilëve kanë përfunduar që nga dt. 1.8.2020.

6 Nëse unë dëshiroj që të më paguhet përfitimi nga kursimet me disponim të lirë para moshës së pensionit?

Parimisht ju mund ta merrni përfitimin tuaj nga kursimet me disponim të lirë vetëm në moshën e pensionit ose nëse ju merrni një pension të plotë invalidi. Por si përashtim tërheqja lejohet tashmë para pensionimit.

Për çdo pagesë nevojitet nënshkrimi i bashkëshortit/bashkëshortes ose i partnerit të/partneres së regjistruar. Përveç kësaj ju duhet të paraqisni dëshmi zyrtare (p.sh. kontratë blerjeje për pronën e banimit, vërtetimin e largimit, dëshmi përvetëpunësimin tuaj, përvështimin tuaj, përvështimi i tij paguhet depozita tuaj e përkujdesjes. Mbi këtë pagesë duhet të paguhen taksa dhe prandaj ajo duhet të deklarohet në deklaratën fiskale. Informacione të hollësishme merrni direkt nga Arka juaj Pensionale ose nga institucioni juaj i kursimeve me disponim të lirë, respektivisht nga autoriteti kantonali tatimor. Në rastet që vijojnë përfitimi nga kursimet me disponim të lirë mund të paguhen plotësisht ose pjesërisht para pensionimit:

a) Nëse unë financoj pronën time të banimit

Deri në moshën 50 vjeç/e ju mund ta merrni përfitimin tuaj nga kursimet me disponim të lirë plotësisht ose pjesërisht për të blerë pronë banimi. Kusht është që bëhet fjalë për vendbanimin tuaj kryesor dhe ju mund të paraqisni një kontratë të shitblerjes. Pas moshës 50 vjeç/e mund të paguhet vetëm një pjesë e pagesës. Vini re: Me marrjen [e këtyre të hollave] reduktohet depozita juaj në shtyllën e 2-të. Kjo çon në pagesa të reduktuarë ose munguese, veçanërisht në moshën e pensionit, në shumicën e rasteve edhe në rast të invaliditetit ose të vdekjes.

b) Nëse unë largohem përfundimisht nga Zvicra

Përfitimi nga kursimet me disponim të lirë mund t'ju paguhet, nëse e dëshironi, kur ju largoheni përfundimisht nga Zvicra dhe sillni një dëshmi për këtë (vërtetim i kontrollit të banorëve etj.).

Nëse ju emigroni në një shtet anëtarë të BE-së-/EFTA-së dhe jeni i/ë siguruar në sigurimin e pensionit të plegërisë, familjar ose të invaliditetit të këtij shteti, ju mund të merrni vetëm atë pjesë të depozitës së përfitimit nga kursimet me disponim të lirë, e cila e kalon minimumin e përcaktuar me ligj. I ashtuquajturi minimumi i BVG-së duhet të mbetet deri në moshën e pensionit ose në hyrjen e një invaliditeti të mundshëm në një llogari përkursimet me disponim të lirë ose një policë nga kursimet me disponim të lirë në Zvicër. Arka juaj Pensionale mund t'ju tregojë saktësisht sa e lartë është shuma e minimumit tuaj të BVG-së. Ai është i shënuar edhe në dëftesën e sigurimit, të cilin e merrni çdo vit nga Arka juaj Pensionale.

c) Nëse unë bëhem i vetëpunësuar

Nëse ju nuk i nënshtroneni më përkujdesjes së detyrueshme profesionale dhe vetëpunësoheni në Zvicër, ju mund të lini t'ju paguhet përfitimi nga kursimet me disponim të lirë. Kusht përkëtë është që ju mund të sillni një vërtetim mbi vetëpunësimin tuaj. Gjatë daljes nga Arka Pensionale e punëdhënësit tuaj të mëparshëm ju duhet të vendosni, nëse dëshironi të merrni të gjithë përfitimin nga kursimet me disponim të lirë ose vetëm një pjesë nga kjo. Sepse vetëm në këtë moment ju mund ta ndani përfitimin nga kursimet me disponim të lirë dhe ta shpërndani në dy institucione të kursimeve me disponim të lirë. Me këtë ju keni mundësi që të merrni vetëm një pjesë të këtij përfitimi, d.m.th. paratë nga një llogari. Sepse në rast të marrjes duhet të mbylljet gjithmonë e gjithë llogaria. Vini re: Me marrjen [e këtyre



të hollave] reduktohet depozita juaj në shtyllën e 2-të. Kjo çon në pagesa të reduktuara ose munguese veçanërisht në moshën e pensionit, në shumicën e rasteve edhe në rast të invaliditetit ose të vdekjes.

d) Nëse përfitimi im nga kursimet me disponim të lirë është tepër i vogël

Nëse përfitimi nga kursimet me disponim të lirë është më i ulët sesa shuma vjetore e kontributeve tuaja, ju mund të bëni kërkesë për pagesën e përfitimit nga kursimet me disponim të lirë. Për të zbuluar, nëse ju e plotësoni këtë kusht, drejtohuni Arkës suaj Pensionale, përpara se ajo t'i transferojë paratë në një institucion të lirimt.

Çfarë ndodh me përfitimin tim nga kursimet me disponim të lirë:

7 Nëse unë shkurorëzohem?

Në rast të zgjidhjes së martesës ose të partneritet të regjistruar secili bashkëshort ose partner, pavarësisht nga regjimi pasuror, ka të drejtë përgjysmën e depozitës së përkujdesjes së shtyllës së 2-të dhe përgjysmën e përfitimit nga kursimet me disponim të lirë, të cilën ka fituar bashkëshorti ose partneri tjetër gjatë martesës ose gjatë kohëzgjatjes së partneritetit të regjistruar.

a) Çfarë ndodh me përfitimin tim nga kursimet me disponim të lirë?

Pavarësisht nga regjimi pasuror ju i keni borxh ish-partnerit tuaj/ish-partneres suaj gjysmën e përfitimit nga kursimet me disponim të lirë, të cilën ju i keni fituar gjatë martesës ose kohëzgjatjes së partneritetit të regjistruar. Pas hyrjes në fuqi të vendimit mbi zgjidhjen e martesës institucioni përkusimet me disponim të lirë e transferon këtë pjesë në favor të ish-partnerit tuaj/ish partneres suaj në Arkén e tij/saj Pensionale ose në institucionin e tij/saj të kursimeve me disponim të lirë.

b) Çfarë ndodh me përfitimin nga kursimet me disponim të lirë të ish-partnerit tim/ish-partneres sime?

Ju keni të drejtë përgjysmën e përfitimit nga kursimet me disponim të lirë, të cilat ish-partneri juaj/ish-partnerja juaj ka fituar gjatë martesës ose gjatë kohëzgjatjes së partneritetit të regjistruar. Gjithashtu ish-partneri juaj/ish-partnerja juaj duhet t'ju paguajë gjysmën e depozitës së tij/saj të përkujdesjes së shtyllës së 2-të në Arkén tuaj Pensionale. Nëse ju nuk jeni siguruar tek një Arkë Pensionale, atëherë paratë duhet t'i transferohen një institucioni të kursimeve me disponim të lirë sipas zgjedhjes suaj.

8 Nëse unë marrë një pension të ri invalidi?

Nëse juve ju është aprovuar një pension i plotë invalidi nga sigurimi konfedertiv kundër invaliditetit (IV), ju mund të kérkonit që institucioni juaj i kursimeve me disponim të lirë t'jua paguan depozitën e nga kursimet me disponim të lirë. Disa institucionet të kursimeve me disponim të lirë ofrojnë edhe mundësinë që të merrni një pension deri në arritjen e moshës së pensionit.

Nëse ju ishit siguruar në një Arkë Pensionale, kur jeni sëmurë ose keni pasur një aksident, rekomandohet që të prisni me tèrheqjen e depozitës nga kursimet me disponim të lirë. Ndoshta përvèç pensionit ju keni të drejtë për një pension invalidi të përkujdesjes profesionale, të cilin duhet t'ju paguante Arka juaj e mëparshme Pensionale. Për ta marrë atë ju duhet t'ia kthenit depozitën tuaj nga kursimet me disponim të lirë përsëri Arkës Pensionale.

9 Nëse unë kam arritur moshën e pensionit?

Ju keni të drejtë për paratë në llogarinë tuaj të lirimt ose të policës suaj të lirimt. Këto mund t'ju paguhen pesë vite para moshës së pensionit dhe jo më vonë sesa pesë vite pas kësaj. Si rregull kjo shumë paguhet menjëherë në formë kapitali.

10 Në rast të vdekjes sime?

Ligji përcakton, cilët persona përfitojnë. Parimisht bëhet fjalë për bashkëshortin/bashkëshorten (ose partnerin /partneren e regjistruar), të cilët janë akoma në jetë, dhe për jetimet. Depozita nga kursimet me disponim të

Ligji përcakton, cilët persona përfitojnë.

lirë u paguhet personave përfitues, si rregull, në një shumë në formë kapitali. Nëse në rast të vdekjes suaj ju nuk lini as një bashkëshort (partner të regjistruar), as fëmijë të mitur, ne ju rekomandojmë që të informoheni tek institucioni i kursimeve me disponim të lirë, nëse dhe cilët marrës të tjerë ju mund të përcaktoni për depozitën tuaj nga kursimet me disponim të lirë dhe si duhet të vepronit lidhur me këtë. Në varësi nga kontrata dhe rregullorja e institucionit tuaj të kursimeve me disponim të lirë është e mundshme pagesa e një pensioni.

Fjalorth

Depozita e moshës ose depozita e përkujdesjes

Depozitë e një personi të siguruar, e cila i shërben financimit të përfitimit të përkujdesjes suaj. Depozita e moshës përbëhet nga shuma e:

- ▶ pagesave të grumbulluara së bashku me interesat
- ▶ kreditimeve të moshës së bashku me interesat;
- ▶ blerjeve vullnetare së bashku me interesat.

BVG / BVG-Minimum

Ligji federal mbi sigurimin e vjetërsisë dhe të mbijetuarve. BVG vendos se kush është i siguruar në mënyrë të obligueshme në përkujdesjen profesionale dhe i përcakton përfitimet, të cilat Arkat Pensionale duhet të parashikojnë si minimum. Arkat Pensionale janë të lira që ta kalojnë minimumin e përcaktuar me ligj të BVG-së.

Institucionet e kursimeve me disponim të lirë

Fondacioni për kursimet me disponim të lirë i shërbejnë ruajtjes së mbrojtjes së përkujdesjes profesionale. Nëse një person i siguruar del nga një institucion i kursimeve me disponim të lirë dhe nuk hyn në një institucion të ri të kursimeve me disponim të lirë, përfitimi i daljes sipas Ligjit për kursimet me disponim të lirë (FZG) duhet të transferohet në një institucion të kursimeve me disponim të lirë.

Përfitimi nga kursimet me disponim të lirë (përfitimi i daljes)

Shuma e cila i kalohet një personi të siguruar gjatë daljes nga një Arkë Pensional. Përfitimi nga kursimet me disponim të lirë përbëhet nga shuma e kontributiveve të punëdhënësve dhe punëmarrësve si dhe nga blerjet ose depozitat duke përfshirë interesat. Përfitimi nga kursimet me disponim të lirë duhet të sillet si përfitim i hyrjes në Arkën e re Pensional.

Arka Pensionale (institucion i përkujdesjes)

Secili punëdhënës duhet të ketë vetë një Arkë Pensionale ose duhet t'i bashkohet një institucion i ekzistues të përkujdesjes (institucion kolektiv ose i përbashkët).

Fondacioni i institucionit të mbledhjes

Punëdhënës duhet t'i bashkohen një institucion i të përkujdesjes. Nëse ata nuk e bëjnë këtë, atëherë ata bashkohen detyrimisht me Fondacionin e institucionit të mbledhjes. Kështu mund të realizohet detyrimi për të siguruar në përkujdesjen profesionale. Përveç kësaj Fondacioni i institucionit të mbledhjes siguron punëmarrësit dhe të vetëpunësuarit, të cilët nuk përfshihen detyrimisht në shtyllën e 2-të, por dëshirojnë të sigurohen vullnetarisht.

Fondacionit të institucionit të mbledhjes duhet t'i transferohen edhe përfitimet e daljes së personave, të cilët dalin nga një institucion i përkujdesjes dhe nuk e njoftojnë atë, në të cilin institucion të ri të përkujdesjes ose institucion të kursimeve me disponim të lirë duhet të transferohet përfitimi i daljes.

Hyrja

Çfarë është një përfitim nga kursimet me disponim të lirë?

Nëse ju jeni siguruar në përkujdesjen profesionale, ju kurseni një depozitë moshe. Kjo përbëhet nga kontributet, të cilat ju vëtë dhe punëdhënësi juaj i paguanit lidhur me pensionimin tuaj si dhe interesat e grumbulluara. Ky kapital ndodhet në një Arkë Pensionale, e cila i investon dhe i administron paratë. Nëse ju dilni nga Arka Pensionale, kjo duhet t'ju bëjë një llogaritje, nga e cila rezulton shuma, të cilën ajo ju ka borxh. Kjo shumë quhet përfitimi nga kursimet me disponim të lirë (ose edhe pagesa në rast të daljes). Këto para janë pjesë e pensionit tuaj të pleqërisë. Prandaj ato duhet të kalohen në Arkën Pensionale të punëdhënësit tuaj të ri. Nëse kjo nuk është e mundshme, atëherë ato transferohen në një institucion për kursimet me disponim të lirë të zgjedhur nga ju.

Ju mund të zgjidhni që përfitimi nga kursimet me disponim të lirë të transferohet në një llogari për kursimet me disponim të lirë ose tek një banke, ose tek një institucion i pavarur për kursimet me disponim të lirë (i cili nuk

është i lidhur me një bankë). Ose ju mund të hapni një policë për kursimet me disponim të lirë tek një sigurim dhe mund të bëni që pagesa juaj e lirimtë transferohet atje. Depozitës në një llogari për kursimet me disponim të lirë ose në një policë për kursimet me disponim të lirë i kreditohen interesa. Varet nga ju që të vendosni pér njëren

ose tjetrën mundësi, të cilat janë në dispozicionin juaj në treg dhe zgjidhjen tuaj t'ia njoftoni sa më shpejtë të jetë e mundur, Arkës Pensionale që keni pasur më përpara. Arka juaj e mëparshme Pensionale ose punëdhënësi juaj i mëparshëm nuk mund t'ju detyrojnë pér asnjë institucion të caktuar pér kursimet me disponim të lirë.

Është e rëndësishme që ju t'ë kujdeseni pér këtë përfitim nga kursimet me disponim të lirë dhe t'ë siguroheni që t'ë transferohet në mënyrë të regulillt, qoftë në Arkën Pensionale të punëdhënësit tuaj të ri, qoftë në një institucion t'ë kursimeve me disponim të lirë. Arka e re Pensionale respektivisht institucioni pér kursimet me disponim të lirë do t'ju dërgojë një vërtetim mbi hyrjen e pagesës suaj fillestare.

Kjo broshurë ju informon
mbi të drejtat dhe detyrimet
tuaja dhe tregon se kujt ju
mund t'ë drejtoheni në rast
të pyetjeve.

Informacione të dobishme

Kujt mund t'i drejtohem në rast të pyetjeve?

Në rast se keni pyetje për shtyllën e 2-të, drejtohuni në plan të parë punëdhënësit tuaj, Arkës suaj Pensional ose institucionit tuaj të kursimeve me disponim të lirë.

Adresa të tjera të dobishme janë:

Zentralstelle 2. Säule (Zyra qendrore e shtyllës së 2-të)

Sicherheitsfonds BVG, Geschäftsstelle (Fondi i sigurisë BVG, zyra)

Eigerplatz 2, Postfach 1023

3000 Bern 14

Tel.: +41 (0)31 380 79 75

E-mail: info@zentralstelle.ch

Internet: www.sfbvg.ch

Fondacioni për kursimet me disponim të lirë për të gjithë Zvicrën (të gjitha gjuhët)

Stiftung Auffangeinrichtung BVG (Fondacioni i institucionit të mbledhjes BVG)

Freifügigkeitskonten (Llogaritë për kapitalin e kursyer)

Postfach

8050 Zürich

Tel.: +41 (0)41 799 75 75

E-mail: sekretariat@aeis.ch

Internet: www.aeis.ch

Përkujdesja profesionale në Zvicrën gjermanofolëse

Stiftung Auffangeinrichtung BVG

Zweigstelle Deutschschweiz

Postfach

8050 Zürich

Tel.: +41 (0)41 799 75 75

Kjo degë është kompetente për kantonet:

AG, AI, AR, BL, BS, GL, LU, NW, OW, SG, SH, SO,

SZ, TG, UR, ZG, ZH.

BE, GR, FR, VS (gjermanofolëse)

Përkujdesja profesionale në Zvicrën frëngjishtfolëse

Fondation institution suppléative LPP

Agence régionale de la Suisse romande

Case postale 660

1006 Lausanne

Tel.: +41 (0)21 340 63 33

Kjo degë është kompetente për kantonet:

GE, JU, NE, VD.

BE, FR, VS (frëngjishtfolëse)

Përkujdesja profesionale në Zvicrën italishtfolëse

Fondazione istituto collettore LPP

Agenzia regionale della Svizzera italiana

Casella postale

6501 Bellinzona

Tel.: +41 (0)91 610 24 24

Kjo degë është kompetente për kantonet:

TI, GR (italishtfolëse)

Informacione dhe këshillim për të siguruarit

Shoqata Njoftime për BVG

www.bvgaukuenfte.ch

Këshillim falas pas caktimit të termimit në Bern,

Brugg, Frauenfeld, Genf, Lausanne, Luzern,

St. Gallen, Winterthur dhe Zürich